

Si rrjedhojë e këtyre diskutimeve, pjesëmarrësit bënë një sërë rekomandimesh për masat e ardhshme:

Rekomandime:

- Një qasje transparente, të drejtpërdrejt dhe të pa paragjykuar në bashkëpunim të mirëfilltë në mes partive politike dhe mediave do kishte qenë me i mirë për pluralizmin politik në media;
- Të rregullohet me ligj çështja e pronësisë së mediave në mënyrë që të parandalohet koncentrimi i mediave tek oligarkë të ndryshëm dhe krijimi i monopoleve të pronësisë së mediave në vendin tonë.
- Mediat duhet të japin qasje të balancuar për grupe të marginalizuara si gratë, komunitetet e ndryshme etnike, dhe mos të kenë ndarje të rreptë linguistike;
- Partitë politike të bashkëpunojnë me media në mënyrë që të rritet diversiteti i paraqitjeve mediale dhe pluralizmi me theks në aspektin gjinor;
- Legjislacioni aktual të mbulojë nevojën e monitorimit të portaleve online dhe veprimtarive politike në mediat sociale në mënyrë që të garantohen standardet dhe zbatimi i kodit të etikës tek këto media;
- Të rritet buxheti i Këshilli të Pavarur për Media në mënyrë që të mundësojë kontrollin dhe monitorimin e mediave, numri i të cilave rritet dita e ditës;
- KPM të bëjë monitorim kuantitativ dhe kualitativ, dhe sistematik përfshi edhe monitorim gjatë dhe jashtë proceseve zgjedhore;
- Mediat, përveç politikave editoriale, të sigurojnë pika kontakti për kontrollin e kualitetit në zbatimin e standardeve, kodit të etikës dhe pluralizmit politik;
- Partitë politike, nuk duhet të abstenojnë dhe sanksionojnë ndonjë medie pasi që në këtë formë ndikojnë në pluralizëm politik në media dhe rrjedhimisht në informim të qytetarëve;
- Të ketë debate të ngjashme me akterët kryesorë dhe relevant në mënyrë që në vazhdimësi të identifikohen të metat në sistem dhe të adresohen nga politika, rregullatorët dhe media në bashkërendim;
- Kuvendi dhe rregullatori në vendosjen e standardëve të kenë parasysh gjendjen socio ekonomike në vendin tonë dhe të përshtatin rregullativën me të;

Rreth projektit:

- Projekti “Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave – JUFREX” promovon lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave në vendin tonë dhe kontribuan në përmirësimin e zbatimit të standardeve evropiane në këtë fushë. Duke u bazuar në rezultatet dhe përvojën e fazës së mëparshme të programit, aksioni do të vazhdojë të punojë me një varg aktorësh, përgjegjës për zbatimin e këtyre standardeve, siç janë: gjyqtarët, prokurorët, avokatët, policët, përfaqësuesit e autoriteteve rregullatore të mediave, gazetarët, studentët dhe aktorët tjerë të mediave.
- Është pjesë e “Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II” – një nismë bashkëpunimi e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës, e cila synon të ndihmojë përfituesit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, që të jenë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të zgjerimit, sipas rastit.

Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të ndonjëres palë.



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

RAPORT PAS TRYEZËS MBROJTJA LIGJORE E PLURALIZMIT POLITIK NË MEDIA





Raport pas tryezës Mbrojtja Ligjore e pluralizmit politik në media

Mediat në vendin tonë gëzojnë mbrojtje ligjore me Kushtetutë, ligje të veçanta dhe akte nënligjore. Bazuar në garantitë ligjore për media, janë themeluar edhe mekanizma rregullativ për sigurimin e pavarësisë së mediave, mbarëvajtjes së punës së tyre, dhe aspektet tjera të ndërlidhura me funksionimin e tyre e që bazohen në standardet ndërkombëtare.

Rrjedhimisht duke u bazuar në po të njëjtën kornizë rregullative, edhe pluralizmi në media gëzon garanci të mjaftueshme ligjore. Megjithatë sfida mbetet mos zbatimi në praktikë.

Nga ana tjetër mbajtja e zgjedhjeve gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ka fuqizuar rolin e medias në përcëimin e mesazhit të partive politike dhe kandidatëve të pavarur tek elektorati, që si rrjedhojë ka rritur nevojën e adresimit të pluralizmit politik në media.

Mu për këtë, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, ka organizuar tryezën "Mbrojtja Ligjore e pluralizmit politik në media" dhe ka përgatitur këtë raport në kuadër të diskutimeve të tryezës së zhvilluar më 29 tetor 2021. Në tryezë është diskutuar mbi:

a) Rregullimin e pluralizmit politik në media me legjislacionin për media jashtë proceseve zgjedhore. Detyrimet e Transmetuesit Shtetëror Publik dhe ato të transmetuesve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore.

b) Detyrimet e autoritetit rregullativ në monitorimin dhe mbrojtjen e pluralizmit politik jashtë proceseve zgjedhore. Detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore. Organet përgjegjëse për monitorimin e mediave elektronike dhe të shkruara.

c) A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë fushatave zgjedhore?

Të ftuar në tryezë kanë qenë përfaqësues të spektrit politik në vend, kandidatë të pavarur politik, përfaqësues nga mekanizmat rregullativ të mediave, përfaqësues të mediave brenda dhe jashtë vendit, etj.

NGA PREZANTIMET DHE DISKUTIMET E PJESËMARRËSVE MUND TË VEÇOHET

Të gjeturat:

- Pavarësisht rritjes së numrit të mediave në vendin tonë ekziston pluralizëm politik në media i cili duhet të ekzistoj si gjatë ashtu edhe jashtë proceseve zgjedhore, por ballafaqohet me vështirësi në zbatim;
- Ekziston rreziku i koncentrimin të pronësisë së mediave tek oligarkët dhe rrjedhimisht krijimi i monopoleve të pronësisë së mediave;
- Ekziston një tendencë e paragjytimeve në mes të mediave dhe partive politike në qasjen e tyre për zhvillime të ndryshme politike, pavarësisht faktit që mbulimi i fushatës zgjedhore për zgjedhje lokale është më i vështirë për shkak të numrit të kandidatëve;
- Ka ndarje me baza etnike të mbulimit të aktiviteteve politike nga mediat, si dhe figurat politike që paraqitën në media janë pothuajse të njëjta, dhe nuk ka balancë gjinore;
- Zhvillimet politike, me theks në veri të vendit, ndikojnë në mbulimin adekuat dhe sigurimin e pluralizmit politik në media;
- Zgjerimi i operatorëve që ofrojnë informim publik si portale online, mediat sociale, etj. të cilët nuk janë të rregulluar, shkakton deformime në lirinë e shprehjes dhe pluralizmin politik në media;



- U paraqitën ankesa për mbulimin e balancuar të kandidatëve të pavarur nga mediat nacionale
- Korniza ligjore në fuqi është e mjaftueshme për rregullimin e mediave, por mungojnë kapacitete financiare dhe humane në monitorimin e zbatimit të kësaj kornize;
- Interes i mangët i mediave dhe gazetarëve për tu informuar me kornizën në fuqi dhe mungesë e kapaciteteve teknike dhe humane nga mediat për zbatimin e obligimeve ligjore siç është pluralizmi politik
- Përkundër interesimit të mangët për informim mbi rregullativ në fuqi, kapaciteteve të mediave për pluralizëm politik, dhe resurseve të mangëta të rregullatorit, KPM vlerëson se ka pasur mbulim të balancuar dhe të drejtë të gjithë kandidatëve dhe partive politike në zgjedhjet lokale;
- KPM monitoron pluralizmin politik në kohë dhe emisione të caktuara të mediave dhe vetëm gjatë zgjedhjeve;
- Monitorimi i KPM-së është monitorim kuantitativ, nuk është sistematik dhe nuk bëhet jashtë periudhave zgjedhore;
- Edhe në vende tjera ka debate të ngjashme dhe pakënaqësi në mënyrën se si garantohet dhe zbatohet pluralizmi politik në media. Nuk ka një praktikë nga vendet tjera që mund të zbatohet në të gjitha vendet dhe rrjedhimisht edhe në vendin tonë;